

RELACION

PËR

AKTIN NORMATIV “PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998 “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Akti normativ që paraqitet për shqyrtim dhe miratim ka për synim një shtesë në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

Ndryshimi me akt normativ synon nxitjen e ndihmave dhe donacioneve nga komuniteti i biznesit për të dëmtuarit nga tërmeti. Për këtë qëllim, është parashikuar që të njihen si shpenzime të zbritshme donacionet deri në masën 5% të fitimit para tatimit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektakti normativ është hartuar në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga situata e emergjencës për shkak të fatkeqësisë natyrore.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKT LIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Pas tërmetit 6.4 të shkallës *Richter* që goditi Shqipërinë në datën 26.11.2019, qeveria ka shpallur gjendjen e jashtëzakonshme në Tiranë dhe Durrës, të cilat janë edhe qarqet më të prekura nga kjo fatkeqësi natyrore.

Të ndodhur në kushtet e emergjencës, si dhe nevojës imediate për mbledhjen e ndihmave humanitare propozohet shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

Projektakti normativ synon shtimin e një pike në nenin e shpenzimeve të panjohura, për të krijuar mundësinë e konsiderimit të këtyre donacioneve si shpenzime të njohura brenda një limiti të caktuar në masën 5%.

Kjo shtesë bëhet me qëllim nxitjen e ndihmave dhe donacioneve nga subjektet juridike që kryejnë aktivitet tregtar për t’i ardhur në ndihmë të dëmturave nga

tërmeti, nga i cili, krahas jetëve të humbura, patën dëme të pallogaritshme materiale.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Projektakti është hartuar në mbështetje të neneve 78, 81, 83, pika 1, 84, pika 4, të Kushtetutës.

V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Neni 1 i projektligjit parashikon njohjen si shpenzim të zbritshëm deri në masën 5% të fitimit para tatimit të donacioneve për shkak të fatkeqësisë natyrore.

Neni 2 parashikon hyrjen në fuqi menjëherë dhe botimin në “Fletoren zyrtare”, kjo bazuar në pikën 4, nenit 84, të Kushtetutës.

“Në rastet e masave të jashtëzakonshme, si dhe në rast nevojë e urgjence, kur Kuvendi vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve dhe Presidenti i Republikës jep pëlqimin, ligji hyn në fuqi menjëherë, vetëm pasi të jetë njoftuar publikisht. Ligji duhet të botohet në numrin më të parë të “Fletores zyrtare”.

VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ngarkohen me zbatimin e këtij projektakti normativ të gjitha institucionet qendrore dhe vendore.

VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Akti normativ është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektakt do të ketë efekte në tatimin mbi fitimin prej 1,7 miliardë lekësh, me supozimin se të gjithë tatimpaguesit e tatimit mbi fitimin do ta përdorin këtë dispozitë.

IX. HYRJA NË FUQI E PROJEKTAKTIT

Ky projektakt normativ do të hyjë në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

KËSHILLI I MINISTRAVE